

THIRRJE PËR OFERTË

Kompani për dizajnim dhe shtyp të produkteve

Programi për të drejtat e njeriut, "HUMAN RIGHTIVISM", i cili mbështetet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (Sida), ka për qëllim që nëpërmjet shoqërisë civile të përmirësoj të drejtat e njeriut, që janë të natyrshme, origjinale dhe të bazuara në interes të grupit, përmes këtyre tri komponentëve: 1) Të drejtat e njeriut dhe aktivizimi arsimor; 2) Dokumentimi; monitorimi (ëatchdog) dhe qasja strategjike dhe 3) Të drejtat mjedisore.

EC Ma Ndryshe është njëra nga organizatat përfituese të këtij programi, në kuadër të cilit ka zhvilluar/hartuar 3 (tre) dokumente/raporte.

EC Ma Ndryshe shpall thirrje përmes së cilës fton, kompanitë/konsorciumet e interesuara të dorëzojnë ofertat e tyre për **"Dizajnim/rradhitjen dhe shtypin e produkteve"**.

Kriteret për ofertim:

Oferta duhet të përmbajë dokumentet në vijim:

- Çertifikata e regjistrimit të biznesit; Çertifikata e numrit fiskal; Çertifikata e TVSH-së (kompanitë që janë deklaruese të TVSH-së),
- Çmimi për koston profesionale për dizajn/rradhitje për copë;
- Çmimin e shtypit për copë (kolor); formati A4; faqet e mbrendshme min.120gr; faqet e kopertinave min.300gr dhe të plastifikuara; secili dokument/raport është rreth 90 faqe; secili dokument/raport parashikohet të shtypet rreth 100 copë;
- Pala ofertuese duhet të caktojë një person për kontakt direkt dhe komunikim me EC Ma Ndryshe.

Ofertat duhet të dorëzohen fizikisht në zyret e EC Ma Ndryshe, Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren ose në mënyrë elektronike në info@ecmandryshe.org deri më datë 14.08.2020, ora 16:00 me shënim: **"Ofertë për dizajnim dhe shtyp të produkteve"**

Ofertat që vijnë pas këtij afati dhe ato që nuk i përmbajnë dokumentet relevante, nuk do të konsiderohen.

Pas vlerësimit fillestar të ofertave, EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën të kërkojë dokumente (dëshmi) shtesë nga kompanitë/konsorciumet, nëse këtë e vlerëson të nevojshme. EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën për të negociuar ofertën financiare. Vetëm kompanitë/konsorciumet fitues do të informohen/kontaktohen.